



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:041672

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05358420

C.nr.323/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: Q.A. dhe S.A. që të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. N.K. nga Prizreni, kundër të paditurve: K.B., D.B., A.B., L.B. dhe T.B., që të gjithë nga Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 22.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia C.nr.323/2021 e datës 04.03.2021, e paditësve: Q.A. dhe S.A. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurve: K.B., D.B., A.B., L.B. dhe T.B., që të gjithë nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë.

A r s y e t i m

Paditësit: Q.A. dhe S.A. që të dy nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre, av. N.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurve: K.B., D.B., A.B., L.B. dhe T.B., që të gjithë nga Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 1,000.00 euro.

Me aktvendimin C.nr.323/2021 e datës 22.12.2023, gjykata ka ftuar paditësit, përkatësisht të autorizuarin e tyre që gjykatës t'i dorëzoj padinë dhe provat në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, përkatësisht provat në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, përkatësisht provat edhe në (3) një kopje tjera, për palën e paditur, brenda afatit prej 3 (tre) ditësh nga pranimi i aktvendimit, me paralajmërimin e pasojave që nëse nuk vepron sipas detyrimit dhe afatit të përcaktuar në pikën nën I. të aktvendimit C.nr.323/2021 e datës 22.12.2023, padia do të hedhet poshtë.

Aktvendimin e lartcekur, i autorizuari i paditësve e ka pranuar më datë 03.01.2024, fakt i cili vërtetohet nga fletëdërgesa e gjykatës e datës 26.12.2023, ndërsa me parashtresën e datës 05.01.2024, i autorizuari i paditësve gjykatës i ka dorëzuar padinë edhe në katër kopje tjera, por nuk ka vepruar sipas aktvendimit C.nr.323/2021 e datës 22.12.2023, përkatësisht nuk ka dorëzuar provat edhe në (3) një kopje tjera.

Në këtë drejtim, gjykata ka ardhur në përfundim se padia e paditësve duhet të hedhet poshtë, në përputhje me nenin 102 par. 4 të LPK-së, pasi që paditësit nuk kanë vepruar sipas urdhrit të dhënë në aktvendimin C.nr.323/2021 e datës 22.12.2023.

Kështu, në nenin 102 par. 4 të LPK-së thuhet që “në qoftë se parashtresat apo dokumentet që i bashkëngjiten nuk janë dorëzuar në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, gjykata do ta ftojë parashtruesin që brenda afatit të caktuar t'i paraqes ato. Po që se parashtruesi nuk vepron sipas

këtij urdhri, gjykata do ta hedhë poshtë parashtresën e tij”. Në anën tjetër, me aktvendimin C.nr.323/2021 e datës 22.12.2023, pala paditëse në mënyrë të qartë dhe konkrete është udhëzuar për plotësimet dhe korrigjimet të cilat duhet të bëhen lidhur me padinë C.nr.323/2021 e datës 04.03.2021, mirëpo e njëjta nuk ka vepruar konform këtyre paralajmërimeve, përkatësisht urdhrave.

Në këtë drejtim, gjykata vë në dukje faktin se është pala paditëse që duhet t’i ofroj gjykatës provat e bashkëngjitura në padi në kopje të mjaftueshme, të cilën gjë pala paditëse ka dështuar ta bëjë.

Andaj, pasi që në përputhje me nenin 171 par. 1 të LPK-së gjykata është e lidhur me aktvendimet e saj, vendosi që padia e paditësve të hedhet poshtë.

Nga se u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 102 par. 4 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.323/2021 të datës 22.02.2024

Gj y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.